

VENDIM
Nr.597, datë 23.7.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.906, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE
TË BARABARTA, PËR SHËRBIMIN KOMBËTAR TË PUNËSIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 8, pikat 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.906, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave, për masat e pronës të Zyrës Vendore të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Devoll, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUEJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror		Ministria e Punes Çështjesh Sociale dhe Shanceve te Barabarta		Identifikoi: Eriona GAXHO, Pergjegjes Sektorit	
Bashkia		Sherbimi Kombetar i Punesimit		(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)	
Bilisht				Supervizori: Brikena NALLBANI, Drejtor i Burim Njerez dhe Sherbimeve	
				(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)	
Fusha e perdorimit te prones		Zyra Vendore e Sherbimit Kombetar te Punesimit Bilisht		Aprovoi: Thoma MIÇO, Drejtor i Pergjithshem tel 2062236	
				(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma vulë)	

Nr rend	A		B		C			Te dhena te tjera (shenime te veçanta)		
	Zona Kadastrale dhe Indeksi i Hartes	Nr Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Siperfaqja Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni/Enti me perdorues. Statusi juridik i perdorimit		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Administrative	Zyre Vendore e SHKP Devoll / Bilisht	55.2	55.2	Zyre Vendore Punesimi	M.P.Ç. S.SH.B	SH.K.P/ ZV SHKP Devoll (ne pronesi)	Ambientet ndodhen ne nje ndertese e cila eshte prone e Bashkise Bilisht Jane gjithsej 3 zyra me siperfaqe 55.2 m2.